

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjykata e Lartë dhe KLP kundër pr/ligjit për pagat e propozuara në Kuvend: Nuk reflekton standardin e K ushtetueses
ADRESA	https://versus.al/aktualitet/gjykata-e-larte-dhe-klp-kunder-pr-ligjit-per-pagat-e-propoz-uara-ne-ku-i46590
BURIMI	versus.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 13:15:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 13:05:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2c8995a747c698698406e75f2972892d3718ca9cebf4cdd6696fe19ba5879cc
TEKSTI	02b9787ea5ea6a35617d8169a482d8406f0e1e02874cbe06c14f9dfabd55cc13
PAMJA	01715daec859cbd98fab6330e2dab0eee67def971fd317923a532f6c34158348

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1df26c547b5abdb309e3e5d49ae36e8eb1e63667941820154f3a42c043fc9b4c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7b60020d12239b3c3f63032b973e8451536e9d643adb77567035503a03c510f7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/1df26c547b5abdb309e3e5d49ae36e8eb1e63667941820154f3a42c043fc9b4c

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[Gjykata e Lartë lë në qeli Erion Veliajn, qytetarët protestuan kundër lirimit të tij! Avokati: Vendim shqetësues](#)

15 Shtator 2026, 11:18

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

—

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

-
-
-
-
-

Created and monetized by
[AKTUALITET](#) / 15 Shtator 2026, 15:05

Gjykata e Lartë dhe KLP kundër pr/ligjit për pagat e propozuara në Kuvend: Nuk reflekton standardin e Kushtetueses

Zv.kryetari i Gjykatës së Lartë, Ilir Panda, tha se vendimi i Gjykatës Kushtetuese është detyrues për Kuvendin dhe se ligjvënësi nuk ka hapësirë për të shmangur standardin e përcaktuar prej saj



Shkruar nga Veritas



Gjykata e Lartë dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë kanë kundërshtuar formulën e propozuar nga mazhoranca për ndryshimin e pagave të magistratëve, duke argumentuar se rritja e parashikuar nuk përbush standardin e vendosur nga Gjykata Kushtetuese.

Në Komisionin për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike po zhvillohen dëgjesat për projektligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ku në fokus është edhe mënyra e re e përllogaritjes së pagave të magistratëve.

Zv.kryetari i Gjykatës së Lartë, Ilir Panda, tha se vendimi i Gjykatës Kushtetuese është detyrues për Kuvendin dhe se ligjvënësi nuk ka hapësirë për të shmangur standardin e përcaktuar prej saj.

Sipas Pandës, problemi qëndron te formula që parashikon rritjen e pagës referuese nga 0.36 në 0.38 të pagës së Presidentit të Republikës.

"Çështja nuk është nëse Kuvendi duhet të ndërhyjë, por nëse zgjidhja e propozuar realizon standardet detyruese që lindin nga vendimi i Kushtetueses, i cili nuk përbën orientim, por detyrim për ligjvënësin", deklaroi Panda.

Ai theksoi se Gjykata Kushtetuese ka kërkuar një referencë dinamike, e cila lidhet me një pagë që pëson rritje periodike dhe që garanton ruajtjen reale të nivelit të mbrojtjes financiare të magistratëve.

Për këtë arsye, Gjykata e Lartë propozon që koeficienti 0.38 të mos përcaktohet në mënyrë fikse në ligj, por të krijohet një mekanizëm që garanton zbatimin e standardit kushtetues edhe në të ardhmen.

Gjykata e Lartë kërkoi gjithashtu që të bëhet një ndarje e qartë mes rregullimit të pagave për të ardhmen dhe pagesave të prapambetura, duke kërkuar që ndryshimet të mos prodhojnë automatikisht efekte mbi funksionare të tjerë publikë.

"Kuvendi ka hapësirë për të zgjedhur formulën, por jo për të mos zbatuar standardin kushtetues. Ligji i ri duhet ta zgjidhë çështjen për të ardhmen, por pa fshirë pasojën e vendimit të Kushtetueses", u shpreh Panda.

Kundër formulës së mazhorancës doli edhe kryetarja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Mirela Bogdani. Ajo e cilësoi rritjen e parashikuar si minimale në raport me përllogaritjet e bëra nga vetë KLP-ja.

"Në referim të atij informacioni që kemi marrë për një rritje 0.02%, pra një rritje që është minimale krahasuar me atë që ka përllogaritur vetë Këshilli, do të thoja se ka një diferencë shumë të madhe", tha Bogdani.

Sipas saj, drafti i propozuar nga mazhoranca parashikon një rritje prej rreth 8,500 lekësh të pagës referuese, ndërsa përllogaritjet e KLP-së e vendosin diferencën në rreth 80 mijë lekë./Versus.al

Poll



AKTUALITET

"Sillini në shtëpi", sheshet e rrugët e Kosovës mbushen me mbishkrime për 4 ish-krerët e UÇK-së

15 Shtator 2026, 14:47

^ekstrakti^



AKTUALITET

Shiste drogëra të forta në Durrës, arrestohet 21 vjeçari! I gjenden qindra doze her*ine e kokaine

15 Shtator 2026, 14:00

^ekstrakti^



AKTUALITET

Kultivoi kanabis në tokë shtetërore, arrestohet 41 vjeçari në Mallakastër

15 Shtator 2026, 13:07

^ekstrakti^



AKTUALITET

Goditet banda shqiptare e drogës në Belgjikë, pjesë e grupit edhe "Gert Gjenerali", i dënuari me burg përjetë

15 Shtator 2026, 12:49

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Helmohen turistët tek 'Premium Beach Hotel' në Golem! U gjet bakter në djath, AKU: Mungesë higjene tek kuzhina](#)

15 Shtator 2026, 12:30

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Veliaj u la në burg, mbrojtja e kryebashkiakut për vendimin e Gjykatës së Lartë: Jashtëzakonisht shqetësues](#)

15 Shtator 2026, 12:13

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Pjesë e grupit të Avdyllajve të Shijakut, kapet në Belgjikë Jasin Avdyli! I dënuar për dosjen 339 dhe 'Volvo 4'](#)

15 Shtator 2026, 11:54

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Korrupsion dhe shpërdorim detyre, kapet në flagrancë polici në Durrës! Procedohen penalisht 2 kolegët e tij](#)

15 Shtator 2026, 11:35

^ekstrakti^

Të fundit





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.